

Simpoziumi Ndërkombëtar për Menaxhimin e Tokave

10-11 Maj 2010
Hanover, Gjermani

International Land Management Symposium

10 and 11 May 2010,
Hannover, Germany



Raport nga pjesëmarrja në Simpoziumin ndërkombëtar

- Vendi:** Courtyard by Marriott Hannover Maschsee Hotel
Arthur-Mange-Ufer 3
Hannover, 30169 Gjermani
- Data:** 10 Maj – 11 Maj 2010-05-17
Mirëseardhja më 09.05.2010
- Organizatori:** Tsak Forca për Zhvillim Rural – Bund-Länder
- Komiteti organizativ:** GLL Hannover (Agency for Geoinformat. Land Development & Real Estate)
- Pjesëmarrësit:** më tepër se 150 përfaqësues të institucioneve të ndryshme përgjegjëse për menaxhimin e tokave dhe zhvillimin rural.
Pjesëmarrës nga MMPH – Luan Nushi, drejtor në Institutin për Planifikim Hapësinor;
- Donator:** Pjesëmarrjen time e bëri të mundur GFA – Consulting Group - si implementues i projektit të udhëhequr nga Rutger Kuiper – team leader
- Vërejtje:** Të gjitha figurat dhe diagramet e prezantuara në raport, janë huazuar nga prezantimet e pjesëmarrësve të ndryshëm në simpozium.
-

Të dhëna të përgjithshme për Gjermaninë

Kryeqyteti -	Berlini
Sipërfaqja -	totale: 357,021 km ² (tokë: 349,223 km ² ; ujë: 7,798 km ²)
Banorë -	82,431,390 (2005)
Gjuha -	Gjermane
Religjioni -	Protestant 34%, Katolik 34%, Mysliman 3.7%, Të tjerë 28.3%
Jetëgjatësia -	Totali: 78.65 vjet (gjinia m: 75.66 vjet; gjinia f: 81.81 vjet (2005))
Organizimi shtetëror:	Republikë federale
Valuta -	euro (EUR)
GDP (per capita) -	\$28,700 (2004)
Të punësuar -	42.63 milion (2004)
Eksporti -	\$893.3 Miliardë (2004)
Importi -	\$716.7 Miliardë (2004)
Pasuritë natyrore -	thëngjill, gaz natyror, hekur, bakër, nikel, uranium, materiale ndërtimi, lëndë drusore, tokë të punueshme bujqësore;

Çka u prezantua dhe çka u diskutua?

Simpoziumi dy-ditor u organizua në Hanover të Gjermanisë, në kryeqytetin e Lowr Saxony (njëri ndër 16 shtetet federative të Gjermanisë), në të cilin morën pjesë afërsisht 150 pjesëmarrës nga vende të ndryshme të Botës. Për dy ditë me radhë u dëgjuan ekspozitë dhe shfaqen prezantime shumë pjesëmarrës, që për emërues të përbashkët kishin vështirësitë dhe problemet me të cilat ballafaqohen lidhur me menaxhimin e tokës dhe zhvillimin e qëndrueshëm rural që ishte edhe tema kryesore e simpoziumit.


Simpoziumi fillojë me prezantimet e përfaqësuesve të Qeverisë qendrore dhe lokale të Gjermanisë të cilët vunë në pah nevojën e ndërmarrjes së veprimeve më konkrete në këtë drejtim. Sipas prezantuesit qëllimet kryesore të shtetit Gjerman janë:

- Ofrimi i kushteve të njëjta jetësore edhe për popullatën në zonat rurale;
- Për shkak të ndryshimeve të shpejta demografike kërkohen ndryshime të shpejta edhe në menaxhimin dhe planifikimin e hapësirave;
- Të iniciohet zhvillimi rajonal - ku në mënyrë direkte do të ndikohet në zhvillimin e zonave rurale;
- Infrastruktura teknike të orientohet edhe në drejtim të zonave rurale;

Qëllimet e mësipërme në mënyrë direkte do të ndikojnë në zhvillimin e integruar rural që momentalisht është jashtë funksionit.

Zhvillimi rural

Më tutje një ekspozitë interesante u paraqit prej Prof. Dr. Ing. Holger Magel i cili prezantimin e tij e filloj me diagramin që është paraqitur më poshtë. Gjithnjë dhe në çdo vend ekzistojnë shtatë funksione kryesore: Edukimi; Furnizimi; Banimi; Puna; Rekreacioni; Trafiku dhe Komunikimi, të cilat në mënyrë direkte veprojnë dhe ndikojnë në njëra tjetrën duke ofruar ose jo kualitetin e nevojshëm jetësor.




Çështja kryesore e prezantimit ishte raporti urban-rural i cili si term ka filluar të përdoret në shekullin 19 kur një pjesë e madhe shteteve evropiane fillojë transformimin nga një mjedis shumë rural në mjedis të zhvilluar industrial. Lidhja urbane-rurale duhet të kuptohet dhe të adresohet në kontekst të globalizimit, i cili e thekson këtë lidhje në aspektin e sistemit të përgjithshëm botëror të prodhimit, financimit, tregtisë dhe tregut të punës. Duhet të ndërroj trajtimin i prapambetur i zonave rurale si zona vetëm bujqësore. Ato së bashku me zonat

urbane duhet të kenë vizion të qartë të zhvillimit të përbashkët. Sipas profesorit janë tre parakushte që ndikojnë në ndërtimin e marrëdhënieve më vitale urbane dhe rurale.


1. planifikim i mirë hapësinor ose territorial – që gjithsesi duhet të përcillet me vullnet të shtuar politik;
2. respektimi dhe njohja e vlerave të dyanshme – që në fakt përforcon bindjen se ato varën njëra nga tjetra, ndihmohen në mes veti dhe nga bashkëpunimi fitojnë që të dyja. Dhe parakushti i tretë është;
3. Shpresa për përkrahje që ende ekziston në të mirë të ruajtjes së zonave rurale, zbrazjes së tyre dhe plakjes së vazhdueshme të popullatës rurale.

Por fatkeqësisht ...

“Bota po bëhet përditë e më URBANE” – kjo shprehet në diagramin e mëposhtëm të profesorit.



Për pasojë – qytetet do të vazhdojnë të rriten, disa prej tyre në qytete shumë të mëdha me të gjitha problemet përcjellëse duke përfshirë edhe plakjen e popullatës si njëri ndër më seriozët. Do të rriten “sllams”(shtëpia të ndërtuara me materiale të lehta), vendbanimet joformale dhe do të shtohet varfëria urbane që momentalisht më të shprehura janë në Afrikë 72% dhe më pak në Evropë 6% nga popullata e përgjithshme urbane.



Cilat duhet të janë veprimet?

- Është e domosdoshme që zhvillimi rural të kthehet prapë në qendrën e agjendës së zhvillimit të përgjithshëm, duke e ditur se zonat rurale i kanë kërkesat më të mëdha por edhe vështirësitë gjithashtu.
- Të fokusohemi në programe të vogla bujqësore dhe rurale – “çdo euro e investuar në bujqësi do të ndikojë dy deri në shtatë herë më shumë në zbutjen e varfërisë se çdo investim tjetër”

Në Evropë ende po vazhdohet me idenë e zhvillimit të qyteteve të qëndrueshme multifunkcionale, duke menduar në të njëjtën kohë në vetëzhvillimin e zonave rurale ku përpos bujqësisë do të ketë edhe funksione tjera.

Prej ndarjes (fig.A)- në marrëdhënie funksionale (fig.B). Më poshtë është prezantuar forma e rekomanduar e bashkëpunimit urban – rural.




Fig. A





Fig. B

“Nëse qytetet vazhdojnë të jenë të vetmet mundësi për punësim, fshatrat dhe rrethinat e qyteteve do të përdorën vetëm për gjumë” – një realitet me të cilin po ballafaqohemi edhe në Kosovë. Një numër i madh i njerëzve për shkak të vendeve të tyre të punës udhëtojnë në drejtim të qyteteve, duke u bërë me këtë rast ngarkesë e panevojshme në trafik dhe duke ndikuar në mënyrë direkte në ndotjen e mjedisit. Prandaj kërkohet:

- zhvillimi i qyteteve në kufijtë ekzistues të tyre;
- shfrytëzimi i zonave të vjetra industriale për destinime në përputhje me kërkesat e reja;
- ripërtërija urbane;
- inicimi i programeve sociale duke përfshirë edhe banimin e favorshëm (afordable housing);
- ngadalësimi i zhvillimit të hovshëm urban në të mirë të zhvillimit të qëndrueshëm;
- më tepër shfrytëzim i kombinuar i hapësirës duke përfshirë funksionet, shërbimet dhe diversitetin e moshës;
- më pak zënie e tokës së punueshme; dhe
- ngritjen e vetëdijes në rëndësinë dhe traditën e bujqësisë.

Duke ju referuar rekomandimeve të dalta në simpozium u propozua skema e konceptit të zhvillimit të integruar rural, me të cilën ndërtohet lidhja vitale urbane-rurale.



Menaxhimi i tokave

Çështje tjetër e trajtuar në simpozium ishte edhe menaxhimi i tokave dhe qasja e përfaqësuesve në gjetjen e skemave më të përshtatshme për menaxhimin e qëndrueshëm të tokave. Një nga këto skema u prezantua nga UN-Habitat-i dhe që në fakt u tregua si model (vegël) që mund të shfrytëzohet nga shtete të ndryshme.





Figure 7. Accessible land management tools.
UN-HABITAT 2004b

Në simpozium u prezantuan edhe shumë instrumente që ndihmojnë në menaxhimin e tokës nga të cilat sipas prezantuesve të rëndësishme janë:

- Planifikimi i koordinuar hapësinor me funksione të qarta urbane dhe rurale (sidomos në banim, transport dhe vende të punës);
- Një vëmendje e shtuar në zhvillimin e periferisë së zonave urbane – duke insistuar në aplikimin e rregullave të aprovuara me kohë;
- Administrimi i tokave, vlerësimi dhe azhurnimi i të dhënave me GIS sistem;
- Planifikimi dhe zhvillimi urban-rural dhe pejsazhor;
- Komunikimi, menaxhimi, motivimi dhe monitorimi;

Një prezantim i rëndësishëm ishte edhe përvoja gjermane në këtë drejtim, e bazuar në teori dhe në raste shumë të mira praktike. Sipas saj menaxhimi i tokave i kombinuar me qeverisjen e tokave, është një kontribut i rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave urban dhe rurale.



Quelle: DGK-Sektion Land- und Immobilienmanagement 2009

Duke u bazuar në këtë skemë dhe në rekomandimet e prezantuesit janë pesë sfida kryesor që duhet të trajtohen nga ekspertët në të mirë të shoqërisë në përgjithësi:

1. Të sigurohet barazia (e zhvillimit) pa dallim nëse është zonë urbane, rurale apo urbane-rurale;
2. Konsultimi, monitorimi dhe motivimi permanent;
3. Administrimi, planifikimi, krijimi i rrjetit dhe koordinimi;
4. Ndërtimi dhe financimi; dhe
5. Matja, rregullimi dhe zgjidhja e konflikteve.

Në përfundim

Këto përvoja mund të realizohen edhe në shtetet në zhvillim, pra shumë lehtë mundë të implementohen edhe në Kosovë. E vetmja gjë që kërkohet (duke u referuar edhe në rekomandimet e simpoziumit) është pikësëpari – vullneti i qartë politik, që gjithsesi duhet të përcillet me përkrahje profesionale adekuat.

Luan Nushi, drejtor
Instituti për Planifikim Hapësinor
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Prishtinë, 18.05.2010